



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:008288

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05763446

KA.nr.449/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Gurëbardhi” ShPK me NUI 811243211 seli në rrugën Abedin Rexha p.nr. në Klinë, kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 20.05.2024 në të cilën mori pjesë përfaqësuesi i të paditurit, ndërsa paditësi nuk mori pjesë, më 31 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Hedhet poshtë padia e paditësit “Gurëbardhi” ShPK me NUI 811243211, kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë, në pjesën me të cilën ka kërkuar anulimin vendimit me numër të protokollit 4142 të datës 08.10.2016 të të paditurit si organ i shkallës së parë.
- II. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Gurëbardhi” ShPK me NUI 811243211, kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër të protokollit 4976 i datës 16.12.2019 i bordit të të paditurit, si organ i shkallës së dytë.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 22.01.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin vendimit me numër të protokollit 4976 i datës 16.12.2019 të bordit të të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, si organ i shkallës së dytë, si dhe anulimin e aktvendimit me numër të protokollit 4142 të datës 08.10.2016 të të paditurit si organ i shkallës së parë

2. Paditësi në padi ka pretenduar se i Padituri ka konsideruar veprimtari ilegale grumbullimin e argjilës, duke menduar se atë do ta shes, pra komercializoj, mirëpo deponimin e argjilës e ka bërë vetëm për hapjen e rrugëve dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë themelore. Gjithashtu ka shtuar se, edhe nëse eventualisht ka kaluar kufirin ekzistues, megjithatë ai nuk ka pasur qëllim përfitimin, por vetëm për qëllim e ka pasur rregullimin ekonomik dhe rikthimin e argjilës sipas programit të rikultivimit. Sipas tij, i Padituri asnjëherë nuk i ka tërhequr vërejtjen për devijimin eventual të fushës jashtë koordinatave. Përveç kësaj, Paditësi ka deklaruar se është ndërmarrje serioze dhe është i pajisur me të gjitha lejet për ta ushtruar në mënyrë legale veprimtarinë e tij. Në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori pjesë fare, ndonëse ishte ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata.
3. I Padituri si në përgjigje në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë. Sipas tij, akti i goditur është në tërësi në pajtim me LPPA dhe në pajtim me dispozitat e nenit 79 par 3,4 dhe 5 të LMM-së. Ka sqaruar se Paditësi ka qenë operues ilegal që ka kryer aktivitet të jashtëligjshëm mineral në lokacionin Tarllabuq në komunën e Vushtrrisë dhe se gjendja faktike është vërtetuar nga inspektorati. Përveç kësaj, ka deklaruar se drejtori dhe pronarja e Paditësit janë shpallur fajtor në procedurë penale për aktivitetin konkret ilegal të shfrytëzimit të mineraleve.

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: aktvendimi me nr. 064/2019 i datës 12.12.2019 i të paditurit; njoftimi me nr.ref. 08 nr. 399/15 i datës 08.08.2016 nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në komunën e Vushtrrisë; njoftimi me nr.ref. 08 nr. 570/16 i datës 15.11.2016 nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në komunën e Vushtrrisë; pëlqimi me numër ref.: KE-290/17 i datës 26.05.2017 i Agjencisë Pyjore të Kosovës; vendimi me nr. 16/5429/1-ZSP-/28/17 i datës 02.02.2017 me të gjitha shtojcat, i MMPH-së; vendimi për leje mjedisore me nr. 18/4074/ZSP/218/19 i datës 26.04.2019 me të gjitha shtojcat, i MMPH-së; vendimi nr. 18/4330/1-ZSP-/269/18 i datës 29.08.2018 me të gjitha shtojcat, i MMPH-së; kontratë për qiranë me nr. ref. 1754/2016 e lidhur me 19.07.2016 te noteri Ilmi Ademi në Vushtrri; kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me nr.ref. 1043/2017 e lidhur më

05.04.2017 te noteri Ilmi Ademi në Vushtrri; certifikata me nr. 18-1847s/16 e datës 24.10.2016 e lëshuar nga ZK në Vushtrri në emër të B.K.; kopja e planit me nr. 18/6565 për parcelat – 00040-0, -00042-0, -00045-0 të ZK Tërllabuq të Vushtrrisë e datës 24.10.2016, me të gjitha shtojcat; licenca për aktivitetet e veçanta me nr. 636/KPMM/2018 lëshuar nga KPMM-ja në emër të paditësit; licencë për shfrytëzim me nr. 1722/KPMM/2017 e lëshuar nga KPMM-ja për paditësin; licenca për shfrytëzim me nr. 1935/KPMM/2019 e lëshuar nga KPMM-ja për paditësin; aktgjykimi me nr. të lëndës P.nr.110/22 i datës 06.06.2023 i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – dega në Vushtrri; shkresat e lëndës të procedurës administrative të dorëzuara nga i padituri përmes përgjigjes në padi, si dhe janë shikuar 11 fotografi.

5. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
6. I Padituri më 05.09.2019 kishte bërë inspektim në lokacionin e shfrytëzimit minerarë në fashitin Tarllabuq të Vushtrrisë dhe kishte konstatuar Paditësi ka kryer aktivet të kundërligjshëm minerar pa posedim të licencës të shfrytëzimit.
7. Në bazë të konstatimeve të mësipërme, i Padituri e ka dhënë vendimin me numër të protokollit 4142 të datës 08.10.2019, me të cilin Paditësit i ka shqiptuar gjobë në lartësi të përgjithshme (kumulative) prej 7,444.76€ për shkeljet nga neni 79 para. 3 dhe 4 të LMM-së.
8. Më 04.11.2019 Paditësi kishte ushtruar ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë, ndërsa i Padituri më 16.12.2019 përmes vendimit të goditur me numër të protokollit 4976 e kishte refuzuar ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë.
9. Gjykata gjithashtu konstaton se dy aksionarët e Paditësit, nga të cilët njëri është edhe drejtor menaxhues, përmes aktgjykimit P.nr.110/22 të datës 06.06.2023 janë shpallur fajtor në bazë të pranimit të fajësisë për veprën penale Aktivitete të Jashtëligjshme Minerare nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale të kryer në bashkëkryerje. Gjegjësisht, me aktgjykim penal ishte konstatuar se me datën 05.09.2019 në fashitin Tarllabuq të Vushtrrisë, si bashkëpronar të kompanisë Gurbardhi ShPK kanë kryer aktivitete të jashtëligjshme minerare për të cilat nuk kanë pasur leje të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, duke përdorur forcën mekanike kanë shfrytëzuar jashtë mase resurset natyrore, ashtu që kanë shfrytëzuar resurset minerale të argjilës pa e siguruar licencën për eksploitim nga ana e organeve kompetente të KPMM-së në

vëllim prej 3,134.31m<sup>2</sup> në sasi prej 6,268.63 ton, duke shkaktuar dëme në shumë prej 2,444.76€.

10. Me aktgjykim penal aksionarët e Paditësit ishin shpallur fajtor edhe për veprën penale Ndotja, Degradimi ose Shkatërrimi i Mjedisit nga neni 338 para. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse me datën 05.09.2019 si bashkëpronar si bashkëpronar të kompanisë Gurbardhi ShPK, në kundërshtim me dispozitat e LMM-së kanë shfrytëzuar jashtë mase resurset natyrore, ashtu që kanë shfrytëzuar resurset minerare të argjilës pa e siguruar licencën për shfrytëzim nga organet kompetente të KPMM-së dhe me përdorimin e forcës mekanike me qëllim të shfrytëzimit të resurseve minerare, kanë krijuar rrezik nga ndotja, degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit.
11. Në bazë të aktgjykimit të cekur më lartë, i cili paraqet dokument publik në kuptim të nenit 329 të LPK-së, dhe për të cilin gjykata është e lidhur në bazë të nenit 14 të LPK-së, gjykata konstatoi se Paditësi e kishte zhvilluar aktiviteti e jashtëligjshëm minerar më 05.09.2019, meqenëse nuk ka pasur licencë përkatëse, siç ka konstatuar i Padituri.
12. Nga provat tjera të administruara, gjykata i gjeti edhe disa fakte tjera, siç është posedimi i disa lejeve mjedisore, megjithatë ato nuk kanë qenë relevant për të vendosur ndryshe, meqenëse me vendim penal të formës së prerë (në bazë të pranimit të fajësisë) është konstatuar se Paditësi ka kryer aktivitet të jashtëligjshëm minerar.

### III. Vlerësimi meritor i rastit

13. Gjykata në rend të parë e vlerësoi padinë e Paditësit me të cilën është goditur vendimi me numër të protokollit me numër të protokollit 4142 të datës 08.10.2016 të të Paditurit, si organ administrativ i shkallës së parë, dhe gjeti se ajo në këtë pjesë është e palejueshme.
14. Neni 13 i LKA-së e ka rregulluar se cili akt administrativ i procedurës administrative mund të goditet me padi. Kështu, në para. 1 të nenit 13 të LKA-së parashihet se *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”*, ndërsa para. 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”*. Sipas këtyre dispozitave juridike, vetëm akti administrativ përfundimtar i nxjerr në shkallën e dytë të procedurës administrative mund të jetë objekt për

shqyrtimin e ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ, ndërsa akti administrativ i shkallës së parë përjashtimisht mund të jetë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ vetëm nëse ndaj tij nuk lejohet ankesa.

15. Në rastin konkret, vendimi i goditur me numër të protokollit të protokollit 4142 të datës 08.10.2016 është akt administrativ i shkallës së parë dhe ndaj tij ka qenë e lejuar ankesa, e madje është ushtruar ankesë në procedurë administrative. Përveç kësaj, ai nuk është akt administrativ përfundimtar, pra nuk është dhënë në fund të procedurës administrative, siç kërkon neni 2 para. 1 nënpara. 2 i LKA-së. Kjo situatë është e rregulluar me nenin 34 para. 1 nënpara. 1.4 të LKA-së, sipas të cilit *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) 1.4. kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;”*.
16. Në këtë kontekst, gjykata e sheh të domosdoshme të sqarojë se kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë e autoriteteve publike në shkallë të parë, në parim, realizohet përmes shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve administrative të lëshuara në shkallë të dytë nga organet administrative. Ky proces përfshin zgjidhjen e çështjeve administrative me juridiksion të plotë, duke marrë përsipër kompetencat e organit administrativ të shkallës së dytë lidhur me ankesat e paraqitura nga palët kundër vendimeve të shkallës së parë. Siç është sqaruar më sipër, gjykata ushtron kontrollin gjyqësor drejtpërdrejtë mbi aktin administrativ të shkallës së parë vetëm në rastet përjashtimore, konkretisht kur ankesa ndaj aktit administrativ të shkallës së parë nuk është e lejuar ose nuk ekziston një organ epror.
17. Prandaj, për këtë gjykatë, padia e Paditësit në pjesën me të cilin e ka goditur aktin administrativ të shkallës së parë është e palejueshme, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 dhe 2 të LKA-së, në lidhje me nenin 13 para. 1 dhe 2 të LKA-së e hodhi poshtë padinë, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
18. Në anën tjetër, në lidhje me kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e vendimit me numër të protokollit 4976 të datës 16.12.2019 të bordit të të paditurit, si organ administrativ i shkallës së dytë, gjykata pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të ndërgjyqësve, gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, si dhe analizimit të dispozitave juridike relevante gjeti se kërkesëpadia e është e pabazuar.

19. Gjykata në rend të parë vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim. Për më tepër, gjykata vlerëson se vendimi i goditur e ka formën e aktit administrativ në përputhje me nenin 47 të LPPA-së si dhe arsyetimi i tij i përmban të gjitha informacionet dhe sqarimet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së. Gjykata rikujton se Paditësi nuk kishte ngritur ndonjë pretendim në këtë aspekt.
20. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Gjykata rikujton se, gjendja faktike e konstatuar nga i Padituri është edhe gjendja faktike e konstatuar në procedurë penale, në bazë të cilës aksionarët e Paditësit ishin shpallur fajtor në bazë të pranimit të fajësisë për kryerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar më 05.09.2019. Në këtë drejtim, gjykata sqaron se në bazë të nenit 14 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së, kjo gjykatë është e lidhur për aktgjykimin penal.
21. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet me nenin 79 të LMM-së, i cili në para 3 ka sanksionuar se *“Nëse një Person shfrytëzon ose eksploaton minerale në mënyrë të paligjshme, KPMM do të shqiptojë këtij personi një gjobë që është e barabartë me trefishin e shumës së rentave minerare të cilat duhet të paguhen për mineralet e shfrytëzuara ose eksploatuara. KPMM do të krijojë një metodologji të arsyeshme për përllogaritjen e sasisë së mineraleve të shfrytëzuara ose eksploatuara në mënyrë të paligjshme dhe do ta caktojë gjobën e lartpërmendur në përputhje me këtë metodologji”*, ndërsa para. 4 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Nëse një person zhvillon aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta pa poseduar Licencën ose Lejen e nevojshme, KPMM do të nxjerrë urdhër përmes të cilit i shqipton këtij Personi një gjobë në shumën prej pesëmijë (5000) Euro për secilin aktivitet të këtyllë”*. Përveç kësaj, paragrafi 5 i të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Gjobat monetare dhe mjetet juridike të përcaktuara në këtë nen janë kumulative (grumbulluese) dhe KPMM do të nxjerrë të gjitha urdhrat e nevojshme për shqiptimin ndaj Personit(ave) përkatës të të gjitha gjobave dhe mjeteve juridike të zbatueshme”*.
22. Nga nenet e cekur rrjedh se i Padituri ka të drejtë të shqiptoj gjobë, e cila për shkeljen e dytë është mandatore, pra fikse, në shumë prej 5000€, ndërsa për shkeljen e parë lejon hapësirë vlerësimi për të Paditurin. Gjykata gjithashtu vlerëson se gjoba e shqiptuar në

mënyrë kumulative në bazë nenit 79 para. 5 të LMM-së është e drejtë dhe proporcionale me shkeljet e konstatuara.

23. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjor nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit.
24. Gjkata i pati parasysh edhe pretendimet tjera të Paditësit, por gjeti se ato nuk ishin relevante për të vendosur ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.
25. Për këto arsye, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të LKA, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.449/2022

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.